

## KU TË RAPORTOHET DHE KU TË KËRKOHET NDIHMË

Është me rëndësi të raportohet dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual në Policinë e Kosovës. Sistemi i drejtësisë është përgjegjës për të siguruar që autorët përballen me drejtësinë.

Ka në dispozicion mbështetje të specializuar për sigurinë, këshillime psikologjike dhe ndihmë juridike falas. Gjithmonë do të bëhen përpjekje për t'i marrë parasysh interesat tuaja.

**Të gjitha informatat që i ndani do jenë konfidenciale. Të gjithë ofruesit e shërbimeve kanë detyrim që ta ruajnë fshehtësinë e të dhënave tuaja personale.**

192



## MBANI MEND!

### PARANDALIMI:

- Diskutoni për dhunën seksuale dhe ngacmimin seksual me njerëz të besueshëm, si mësimdhënësit, prindërit, pedagogët/psikologët dhe miqtë. Kurrë mos përdorni forcë, shtrëngim, kërcënim, apo të përfitonit nga situatat e cënueshme për t'u përfshirë në aktivitete seksuale. Merrni përgjegjësi për veprimet tuaja!
- Nëse nuk keni thënë JO nuk do të thotë se jeni pajtuar! Trupi im, zgjedhja ime!
- Të gjithë kanë autonomi të trupit - vajzat e djemtë, gratë e burrat!

### MBROJTJA:

- Askush nuk duhet t'ju detyrojë që të flisni me policinë. Për arsye të ndryshme shumë njerëz nuk flasin me policinë.
- Nëse ndiheni të sigurt dhe keni vendosur të raportoni, shfrytëzoni zërin tuaj për ta parandaluar dhunën! Bisedoni me një person që i besoni dhe raportoni në Policinë e Kosovës! Ngriteni zërin! Askush nuk ka të drejtë t'ju sulmojë apo ngacmojë seksualisht bazuar në veshjen apo dukjen tuaj.
- Mendoni që t'i ndani përvojat tuaja- mbani mend, zëri juaj është i rëndësishëm dhe ka forcë t'i ndihmojë dhe fuqizojë të tjerët. Por, para se të flisni, sigurohuni që ndiheni mirë dhe sigurt.
- Ndani historinë tuaj me të tjerë ashtu që t'i ndihmoni të tjerët por të mos e lëndoni veten. Thirrni numrin 192!

## DHUNA SEKSUALE DHE NGACMIMI SEKSUAL JANË VEPRA PENALE - NUK JANË FAJI JUAJ!

**Zëri juaj është i fuqishëm dhe bën ndryshim!**

**Nëse keni nevojë për ndihmë, thirrni Policinë e Kosovës në numrin 192.**

**Flisni me dikë që ju bën të ndiheni të sigurt: me një person të rritur të cilit i besoni, prindin, anëtar të familjes, mësimdhënësin ose psikologun e shkollës.**

**NGRITENI ZËRIN!  
RAPORTONI!  
KËRKONI MBËSHTETJE!**

Të gjithë mund të preken nga dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual, fizik apo në internet, por gratë dhe vajzat përbëjnë përqindjen më të madhe të të mbijetuarve për shkak të normave mbizotëruese dhe të dëmshme të raporteve gjinore.

Elementi kyç që bën dallimin midis aktit seksual dhe dhunës seksuale është **PËLQIMI**. Nëse nuk keni thënë JO nuk do të thotë se keni thënë PO!

Dhënia e pëlqimit do të thotë të pranosh aktivisht të marrësh pjesë në një aktivitet seksual. Para se të përfshiheni në aktivitetin seksual me një partner, është me rëndësi që të dy të dëshironi dhe të pajtoheni me këtë - edhe fjalët edhe gjuha e trupit ndihmojnë në dhënien e pëlqimit.

Ju keni të drejtë të thoni **JO** në çdo kohë. **JO** është **JO**.

## LLOJET E DHUNËS SEKSUALE:

- **Përdhunimi dhe përdhunimi në tentativë**
- **Abuzimi seksual i fëmijëve**
- **Incesti**
- **Sulmi seksual**
- **Prekja e padëshiruar**
- **Martesa e detyruar**
- **Prostitucioni i detyruar**
- **Trafikimi seksual**
- **Shtatzënia e detyruar**
- **Ngacmimi seksual**
- **Dhuna seksuale në kontekst të marrëdhënieve intime**
- **Abuzimi seksual në internet**
- **Abuzimi seksual pa kontakt**

## STATISTIKA NGA INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE PËR RASTET E DHUNËS SEKSUALE 2020 -2021

- Shumica e të mbijetuarve të dhunës seksuale janë të moshës nga 11 deri në 16 vjeç.
- Në 81% të rasteve të dhunës seksuale, të mbijetuarit e njohin kryerësin.
- Provat biologjike mbledhen vetëm në 28% të rasteve të dhunës seksuale.
- Rreth 90% e të mbijetuarve të dhunës seksuale janë gra dhe vajza.

## ÇFARË ËSHTË NGACMIMI SEKSUAL?

Ngacmimi seksual mund të jetë në forma të ndryshme, duke përfshirë me fjalë, gjeste ose veprime, apo edhe ekspozimi në imazhe pornografike, emaila dhe mesazhe me tekst me përmbajtje seksuale të shpërndara edhe përmes platformave të mediave sociale.

Ngacmimi seksual mund të marrë forma të ndryshme dhe secila prej tyre është e dëmshme. Ato mund të ndikojnë në shëndetin tuaj dhe të jenë me rrezik për jetë.

Ngacmimi seksual është veprë penale. Kurrë nuk duhet të tolerohet.